



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 7.3.2025

Nr: 245

Ora: 18:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
BULQIZË PËR PERIUdhËN 23 SHKURT-1 MARS 2025**

Sot, më datë 7.3.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Bashkia Bulqizë

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Bulqizë për periudhën 23 shkurt-1 mars 2025

BAZA LIGJORE: Nenet 19, pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 23 shkurt 2025-1 mars 2025, **Bashkia Bulqizë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor me tematikë si më poshtë vijon:

- “Takim me nxënësit ekselentë, ditë e hapur në Bashki me to”, raportuar në datë 1.3.2025 për t’u zhvilluar në datë 5.3.2025.

Data: 7.3.2025 Nr: 245
Ora: 18:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Bulqizë për periudhën 23 shkurt-1 mars 2025”

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Bulqizë një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Bulqizë ka dërguar pretendimet, duke sqaruar si vijon: *“Pas marrjes dijani të vendimit nr. 233 dt 4.3.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me fillimin e shqyrtimit administrativ ndaj Bashkisë Bulqizë për raportimin e një veprimtarie jashtë afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor me tematikë “Takim me nxënësit ekselentë, ditë e hapur në Bashki me ta” ju sqarojmë se aktiviteti i ndaluar, që është në shqyrtim nga ana juaj, u anulua dhe nuk u zhvillua sot, më datë 5.3.2025”.*

Për sa më sipër, pasi u njoha me arsyet e paraqitura nga ana e personit përgjegjës për raportimet, vlerësoj se veprimtaria publike e raportuar nga Bashkia Bulqizë, nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Pasi veprimtaria kanë marrë shënimin si e ndaluar, aktiviteti nuk është zhvilluar në datën dhe orën e raportuar në ndërfaqen elektronike.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, nenit 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Bulqizë.
2. Ky vendim njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI